



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-1732
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-04-
Data: Datum: Date: 12.04.2022	
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

REFERENCË:	msh/dshb/mgj/ 76 / 04 / 2022				
PËR/ZA/TO:	Prof. Dr. Rifat LATIFI, Ministër i Shëndetësisë;				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
CC:	Znj. Albulena HAXHIU Ministre e Drejtësisë; Z. Kujtim SALIHU, Shef i Kabinetit të Ministrit të Shëndetësisë; Dr. Naim BARDIQLI, Sekretar i Përgjithshëm i MSh; Z. Ali GASHI, Zv. Drejtor i ShKK/MD				
NGA/OD/FROM:	Prof. Asoc. Dr. Milazim H. GJOCAJ, MD, MSc, PhD, Drejtor i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve MSh;				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport përmbledhës i aktiviteteve të DShB për tremujorin e parë të vitit 2022				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	107	Lokacioni: Kucni: Extension:	MSh	Data: Datum: Date:	12.04.2022
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>

I nderuar zoti Ministër, Prof. Dr. Rifat Latifi,

Departamenti shëndetësor i burgjeve, bazuar në planin e punës për vitin 2022, buxhetin e aprovuar, stafin që posedon, përpjekjet për zbatimin e Praktikave Standarde të Veprimit, menaxhimin e pandemisë në burgje konform Rekomandimeve të Këshillit të Evropës, ka kryer aktivitet e parapara sipas tabelave të më poshtme:

Tabela numër 1, përmbledhje tre mujore e indikatorëve të aktiviteteve shëndetësore në DShB

Të dhënat mbi disa indikatorë të DShB, Janra -Mars 2022		Muajt			Totali,	Totali,
Nr	Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	tremujori i parë 2022	tremujori i parë 2021
1	Te burgosur te pranuar	458	417	447	1322	1191
2	Te burgosur te liruuar	396	344	379	1119	725
3	Vizita e pare mjekesore ne pranim	456	414	447	1317	1195
4	Konsulta mjekesore	3221	2533	2350	8104	7866
5	Konsulta psikiatrike	574	609	652	1835	1480
6	Konsulta psikologjike	614	661	678	1953	1449
7	Sherbime dentare	309	234	297	840	622
8	Sherbime te tjera mjekesore	1502	1517	1588	4607	4663
9	Totali i konsultimeve shendetesore	5884	5504	5052	16440	14380
10	Hospitalizime ne Stacionarin e burgut	10	12	10	32	24
11	Hospitalizime ne Spitalet Civile	20	12	22	54	44
12	Dergimet jashtë IK per konsultime	265	211	227	703	446
13	Dergimet jashte IK per intervenime	38	34	24	96	57
14	Transferet shendetesore	0	4	5	9	43
15	Rastet me TBC	1	0	0	1	0
16	Rastet me HEPATIT B	2	0	1	3	0
17	Rastet me HEPATIT C	0	1	1	2	0
18	Rastet HIV pozitiv	0	0	0	0	0
19	Aplikimi i Testeve Psikologjike	206	207	191	604	422
20	Analizat e gjakut sipas planit	80	97	86	263	116
21	Analizat e gjakut sipas indikacioneve	57	59	35	151	89
22	Analizat e gjakut per substancave psikotrope	0	6	0	6	22
23	Vizitat sistematike muojre (parametrave vital)	1095	1302	1036	3433	3741
24	Kontrollet stomatologjike sistematike	0	0	20	20	19
25	Kontrollet gjinekologjike sistematike	0	0	0	0	0
26	Mamografi	0	0	0	0	0
27	PAPA test	0	0	0	0	0
28	RTG Pulmo	8	16	7	31	43
29	Neurotic Syndromes	263	263	272	798	648
30	Psychotic Syndromes	39	49	42	130	105
31	Semundjet kardiovaskulare	70	77	88	235	211
32	Semundjet Respiratore	265	186	118	569	459
33	Semundjet gastrointestinale	131	119	110	360	391
34	Semundjet urogenitale	56	54	44	154	132
35	Semundjet e lekures	59	70	81	210	253
36	SS te transmetueshme	3	0	0	3	2
37	Semundjet e sistemit lokomotor	127	109	129	365	364
38	Semundjet infektive	5	8	5	18	7
39	Vete lendimet	13	9	7	29	29
40	Lendimet trupore	41	28	26	95	71
41	Abuzimet seksuale	0	0	0	0	1
42	Rastet ne greve te urise	13	3	4	20	11
43	Tentim vetevrasjet	3	2	2	7	3
44	Vetmia - Izolimi	45	48	61	154	184
45	Vdekjet ne burg	1	1	0	2	2

Bazuar në tabelën numër një, ku janë prezantuar të dhënat epidemiologjike duke i krahasuar tremujorin e parë të këtij viti dhe atij paraprak, mund të konstatohet si në vijim:

1. Ecuria e aktiviteteve dhe indikatorëve është pothuajse e njëjtë me një trend të rritjes graduale dhe jo signifikante;
2. Ka një shtim të numrit të burgosurve e si pasojë edhe e lirimeve po ashtu, pra ka qarkullim më të madh të të burgosurve gjatë vitit 2022.
3. Gjatë këtij tremujori, krahasuar me atë të vitit paraprak, ka shtim të aktiviteteve si ato mjekësore, psikologjike, psikiatrike, dentare dhe total konsultime.
4. Gjatë këtij tremujori, në krahasim e atë të vitit 2021 ka shtim të aplikimit të testeve psikologjike dhe analizave laboratorike, qofshin ato të planifikuara apo sipas indikacioneve. Këto aktivitete janë shtuar si rezultat i angazhimit të shërbimit për punë më të shtuar për parandalim të vetëvrasjeve dhe identifikimit të rasteve më çrregullime mendore si dhe për diagnostikimin e sëmundjeve të ndryshme që në praninë. Po ashtu vlen të theksohet se janë funksionalizuar laboratorët në të gjitha NjShB-të.
5. Trendi i sëmundjeve edhe këtë periudhë është i njëjtë me atë paraprake, pa ndonjë ndryshim të theksuar, signifikant.
6. Këtë tremujor janë shtuar lëndimet trupore dhe tentim vetëvrasjet krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa është zvogëluar numri i vetmive për të burgosurit.

Shërbimet e shëndetit mendor në burgje edhe në vitin 2022 kanë vazhduar me kryerjen e të gjitha shërbimeve me theks të veçantë në masat e shtuar për detektimin dhe menaxhimin e rasteve me rrezik potencial për vetëvrasje apo vetëlëndim.

Shërbime e shëndetit mendor në burgje, duke përfshirë intervistat e para psikologjike, ekzaminimi i statusit mendor, ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes psikologjike dhe vizitat psikiatrike janë ofruar sipas planit.

Tab 2. Shërbimet e shëndetit mendor në kuadër të të gjitha shërbimeve shëndetësore në burgjet e Kosovës në vitin 2021

Shërbimet e shëndetit mendor të ofruara në burgje		
Viti	Shërbimi	Numri
3M 2022	Konsulta shëndetësore	8130
3M 2022	Vizita psikiatrike	1835
3M 2022	Seanca psikologjike	1969

Afro gjysma e shërbimeve shëndetësore, përkatësisht 47% e të gjitha shërbimeve mjekësorë të ofruara në burgjet e Kosovës gjatë tremujorit të parë të vitit 2022 përbëhen nga shërbimet e shëndetit mendor. Vizitat psikiatrike, vlerësimet psikologjike, seancat e psikoedukimit, këshillimit, përkrahjes emocionale dhe psikoterapisë përbëjnë shërbimet kryesore të shëndetit mendor në burgje.

Rastet janë vënë në menaxhim të ekipeve multidisiplinare për menaxhimin e personave me rrezik për vetëvrasje në të gjitha burgjet. Sipas kushteve të përcaktuara në Strategjinë për Parandalimin dhe Menaxhimin e Rasteve me Rrezik për Vetëvrasje nga Procedura Standarde e Veprimt, 2019/DSHB, janë arkivuar në DSHB së bashku me raportet e vazhdueshme të punës së këtyre komisioneve të emëruara me vendim të përbashkët të udhëheqësve të njësive dhe drejtorëve të burgjeve.

Tabela numër 2, përmbledhje tre mujore e disa indikatorëve specifik të DShB

Raportimi i tremujorit të parë, për vitin 2022, për disa indikatorëve në burgje							Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2021	
Nr	Lloji i të dhënave	Janar	Shkurt	Mars	Total	Përqindje	Total	Përqindje
1	Numri i të vizituarve për herë të parë	458	417	447	1,322	100.00	1,191	100.00
2	Numri i duhangjinjeve	342	258	302	902	68.23	814	68.35
3	Numri i abuzuesve të alkoolit	41	35	29	105	7.94	94	7.89
4	Numri i abuzuesve të drogave	70	66	86	222	16.79	182	15.28
5	Rastet me Hepatitis B	1	0	1	2	0.15	-	-
6	Rastet me Hepatitis C	0	3	1	4	0.30	1	0.08
7	Rastet me lendime trupore	38	27	17	82	6.20	60	5.04
8	Rastet me TBC	1	0	0	1	0.08	-	-
9	Rastet me Diabet	11	8	7	26	1.97	30	2.52
10	Rastet me SST (AIDS)	0	0	0	-	-	7	0.59
11	Rastet me Hipertension Arterial	24	27	32	83	6.28	73	6.13

Bazuar në krahasimet e disa indikatorëve specifike rezultojnë se si në këtë tremujor, ashtu edhe në atë të vitit 2021, duhan pirja, alkooli kanë një përqindje të ngjashme. Dallim bënë shtimi i përqindjes së përdoruesve të drogave e si duket si pasojë edhe rasteve më Hepatit C.

Në këtë periudhë nuk ka pasur raste të infektuar me Coronavirs. Ka vazhduar zbatimi i masave kundër epidemiologjike, si DDD e të gjitha hapësirave të burgjeve, higjiena personale dhe e hapësirave. Vaksinimi sipas planit për të gjitha dozat, përfshirë edhe atë përforcuese. Mbi 97% e të burgosurve dhe stafit kanë përfunduar vaksinimin. Çdo dy jave organizohet raundi i ri i vaksinimit për të mbuluar rastet që vijnë nga jashtë e që nuk janë të vaksinuar.

Furnizimet me barëra, material mjekësor, administrativë, të higjienës dhe mjete mbrojtëse ka qenë i qëndrueshëm dhe sipas planit.

Në vazhdimësi jemi duke zhvilluar aktivitete lidhur me menaxhimin e gjendjes shëndetësore të të burgosurve dhe ndërmarrjen e aktiviteteve përkatëse, bazuar në planin e punës dhe PSV-të për trajtimin shëndetësor të të burgosurve.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Me respekt!